



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prilato Received/Delivery	07-04	2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHKIPAR	1663/2021		1/6	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.185/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2938/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.581/2019 të datës 26.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati “Koretin” në Komunën e Kamenicës, kundër Vendimit me Nr.14 të datës 23.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.581/2019 e datës 26.09.2019 e parashtruar nga ankuesi

II.SHFUQIZOHET Vendimi me Nr.14 i datës 23.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës.

III.ANULOHET masa disiplinore “vërejtje” e datës 27.06.2019 e shqiptuar ndaj ankuesit nga Kryetari i Komunës së Kamenicës.

IV.DETYROHET Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kamenicës, që brenda afatit prej 15 ditësh nda dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj/shlyej masën disiplinore të ankuesit nga dosja personale.

V.OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Kamenicës, që të ndërmarr veprime juridike që ky vendim të zbatohet sipas pikës III të tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Ndryshim dhe plotësim të Aktit të Emërimit të datës 02.11.2014 në pozitën “Përfaqësues Ligjor i Komunës”, më datë 03.06.2019 Kryetari i Komunës së Kamenicës ka iniciuar procedurën disiplinore për shkelje të detyrave të punës me arsyetim se:

përfaqësues ligjor i Komunës, ka dorëzuar në Zyrën e Kryetarit shkresën 02/15211 të datës 30.05.2019 në të cilën i njëjti shpifë ndaj meje në deklaratën e tij lidhur me vonesën e nënshkrimeve të autorizimeve, gjë për të cilën i kam kërkuar raport, dhe i njëjti më ka përcjell shkresën 02/15374, ku ai nuk dëshmon as datën kur autorizimet i ka sjell për nënshkrim dhe as datën kur ato janë nënshkruara dhe janë pranuar nga z. e radhës në po të njëjtën fjali është deklarata e tij që vonesa e nënshkrimeve nga ana ime është e qëllimshme, ndërkohë që i njëjti nuk ka sjell asnjë dëshmi edhe pasi që ia kam kërkuar, që një gjë e tillë ka ndodhur. Në tekstin “po ashtu kërkoj nga ju si Kryetar i Komunës ti ndalni presionet në punë ndaj meje dhe bashkëshortes ime si udhëheqëse e administratës në QKMF në Kamenicë, presione këto që po vazhdoni çdo ditë sikurse që vazhduar me mua ku më datën 21.05.2019 rreth orës 15:30 në zyrën tuaj duke më kërcënuar duke më bërtitur më zë të latë a din se për 5 minuta të qoj të shpija, po ashtu më datë 22.05.2019 prapë vazhduar me presion/kërcënim duke thënë se vazhdoj të kem atë mendim për vlerësimin e rezultateve në punë dhe tash po të qes në komision disiplinor, është po ashtu shpifje ndaj meje për shkak se këto ngjarje nuk kanë ndodhur fare siç i përshkruan dhe këto fjali nuk i kam thënë unë në asnjërin prej takimeve me të. Kjo mund të vërtetohet me dëshmitarët që kanë qenë në takim, pasi që vlen të shtohet këtu që unë nga data 25.03.2019 të njëjtin nuk e kam takuar asnjëherë vetëm, për shkak se i njëjti në këtë datë më ka kërcënuar përmes mesazheve telefonike dhe ka vazhduar njësoj edhe në raste tjera, edhe në deklarata publike në portale lokale, e ndaluar në mënyrë si është shprehur sipas Kodit të Mirësjelljes për Nëpunësit Civil (Neni 13 paragrafi 4)...”

Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenicës, më datë 20.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 05/2019 me të cilin shpallet jo kompetent për të vendosur në këtë çështje juridike administrative duke konstatuar që për shkelje të lehta është kompetencë e udhëheqësit të drejtpërdrejt.

Kryetari i Komunës së Kamenicës pas vendimit të Komisionit Disiplinor, më datë 27.06.2019 ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore “vërejtje”.

Ankuesi kundër vërejtjes, më datë 26.07.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kamenicës, më datë 23.08.2019 nxjerr Vendim me Nr.14 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi masën disiplinore.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.14 të datës 23.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.09.2019 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 26.09.2019 me numër protokollit 4537/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 27.09.2019 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Kamenicës. Këshilli më datë 14.10.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Kamenicës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 04.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2938/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 04.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 26.09.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 26.09.2019 me numër protokollit 4537/2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.14 të datës 23.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës; Vendimin e datës 19.06.2019; Vërejtjen e datës 27.06.2019; Ankesën e datës 26.07.2019 të ankuesit e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës; Zarin e datës 24.09.2019; Raporti i një shkelje disiplinore të supozuar i datës 03.06.2019; Njoftim për fillimin e procedurës disiplinore i datës 06.06.2019; Flete kthesën e datës 06.06.2019; Vendimin me Nr. 05/2019 të datës 20.06.2019 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Kamenicës; Procesverbal i datës 23.08.2019; Fletëkthesa 01/26/08/2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2018, 06.03.2019, 19.12.2017; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 01.12.2014 i ankuesit; E-mailin e datës 23.07.2019 nga Qëndron Kastrati; Procesverbalin e datës 24.07.2019; Njoftimin e datës 10.10.2019 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 14.10.2019 me numër protokollit 4823/2019; Njoftimin e datës 04.11.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.2938/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që: nuk ka qenë i njoftuar se çfarë shkelje ka bërë pasi që as komisioni disiplinor nuk ka mbajtur ndonjë seancë që të njoftohet për shkeljen e supozuar duke mos pasur fare qasje lidhur me shkeljen që kinse kam bërë dhe i njëjti vendim nuk më është dërguar; Vërejtja e shqiptuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi që nga data 19.06.2019 jam i pezulluar nga marrëdhënia e punës për tre muaj

prandaj është jo ligjore të merren masa arbitrare nga Kryetari i Komunës; Komisioni për Ankesa me rastin e refuzimit të ankesës sime nuk ka dhënë arsyetime të sakta.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që nuk ka qenë i njoftuar se çfarë shkelje ka bërë pasi që as komisioni disiplinor nuk ka mbajtur seancë që të njoftohet për shkeljen e supozuar duke mos pasur fare qasje lidhur me shkeljen që kinse kam bërë dhe i njëjti vendim nuk më është dërguar, ka konstatuar që ndaj ankuesit më datë 03.06.2019 nga Kryetari i Komunës së Kamenicës është inicuar procedurë disiplinore me çka rasti është paraqitur në komisionin disiplinor, ndërsa më datë 06.06.2019 ankuesi nëpërmjet njoftimit është njoftuar për fillimin e procedurës disiplinore, mirëpo nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të është njoftuar se për shkelje të detyrave të punës është inicuar procedura disiplinore, siç parashihet me nenin 12 paragrafin 3 nën paragrafin 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Udhëheqësi i njësisë së personelit, pas paraqitjes së rastit në komisionin disiplinor, e njofton me shkrim shkelësin e dyshuar brenda tri (3) ditë punë, për: natyrën e shkeljes së dyshuar, paraqitjen e rastit për shqyrtim te komisioni disiplinor, kohën dhe vendin ku do të mbahet seanca e komisionit disiplinor dhe mundësin e shkelësit që të shoqërohet nga një person tjetër në seancë, me të cilin mund të këshillohet”*, si rrjedhojë përveç që ankuesi është njoftuar që ndaj tij ka filluar procedurë disiplinore nuk ka asnjë dëshmi që janë respektuar procedurat e lartcekura, po ashtu në bazë të provave të lëndës nuk ka asnjë dëshmi që për rastin e ankuesit është mbajtur seancë nga komisioni disiplinor për t’u njoftuar për shkeljen e supozuar siç parashihet me nenin 14 paragrafit 1 Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, me ç’rast Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenicës, më datë 20.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 05/2019 me të cilin shpallet jo kompetent për të vendosur në këtë çështje juridike administrative duke konstatuar që për shkelje të lehta është kompetencë e udhëheqësit të drejtpërdrejt, mirëpo edhe pse është kërkuar si provë nuk ka asnjë dëshmi që ky vendim i është përcjell ankuesit si palë në procedurë duke vepruar në kundërshtim me nenin 14 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Vendimi i komisionit duhet të jetë me shkrim dhe duhet t’i komunikohet shkelësit nga udhëheqësi i njësisë së personelit brenda tri (3) ditë pune nga marrja e vendimit”*, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që vërejtja e shqiptuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi që nga data 19.06.2019 jam i pezulluar nga marrëdhënia e punës për tre muaj prandaj është jo ligjore të merren masa arbitrare nga Kryetari i Komunës, ka konstatuar që edhe pse ndaj ankuesit më datë 03.06.2019 është inicuar procedurë disiplinore, më datë 19.06.2019 Kryetari i Komunës së Kamenicës ka nxjerr Vendim me Nr. 17465 me të cilin ankuesin e ka pezulluar me pagesë nga puna prej tre (3) muajve në pritje të një hetimi, si rrjedhojë edhe pse ndaj ankuesit është inicuar procedurë disiplinore nuk ka mund të nxjerr asnjë vendim tjetër i cili ka për pasojë marrëdhënien e punës pasi që vetëm rasti i tij ka qenë duke u trajtuar nga Komisioni Disiplinor, po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që masa disiplinore “vërejtje” e shqiptuar më datë 27.06.2019 nga Kryetari i Komunës së Kamenicës ndaj ankuesit është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e nenit 67 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 pikës 1.1.2 respektivisht 1.1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 respektivisht 1.3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, sepse është titulluar vetëm si “vërejtje” ndërsa në brendësi është dhënë vërejtje me shkrim, kështu që masa duhet të jetë e titulluar siç e parashohin dispozitat e lartcekura, po ashtu në masën disiplinore të shqiptuar thuhet që e njëjta është shqiptuar në bazë të rekomandimit të Komisionit Disiplinor në Vendimin e datës 20.06.2019, mirëpo në të nuk është dhënë asnjë arsye se cilat kanë qenë shkeljet që ankuesi ka bërë dhe në cilën kohë është bërë shkelja e supozuar nga ankuesi. Me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-

031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij siç përcaktohet, kështu që arsyetimi i një mase të tillë është në kundërshtim me tërë nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Komisioni për Ankesa me rastin e refuzimit të ankesës sime nuk ka dhënë arsye të sakta, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kamenicës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 14 të datës 23.08.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kamenicës detyrohet, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë largimin/shlyerjen e masës disiplinore të ankuesit nga dosja personale e tij sipas nenit 51 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa Kryetari i Komunës së Kamenicës është i obliguar, që të ndërmarr veprime juridike që ky vendim të zbatohet sipas pikës III të tij.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.185/2021, datë 07/04/2021



Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.